



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 9.3.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq,
Emilija Redzepi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 3.3.2016,
3. Shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve për Drejtor dhe Zv. Drejtor në Autoritetin e ujërave,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje, mirëpo **Shaip Muja** ndërpreu këtë pikë duke kërkuar që komisioni të vendos për tu drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkuar nga Qeveria dokumentacionin për demarkacionin me Malin e Zi ngase sipas tij qëllimisht shkaktohet mjegullia për kompetenca rreth kufirit, gjithashtu shtoi se Presidentja nuk ka drejt ligjore të formoi grup punues ngase ajo vepron vetëm pas efekteve juridike.

Duda Balje potencoi se kjo çështje ka marr dritën e gjelbër në kryesi që ky komision shqyrton këtë çështje.

Murat Hoxha tha se puna në Qeveri ka marr fund ngase komisioni përkatës ka kryer punën, Qeveria nëse dërgon Kuvendit për ratifikim na komisioni vazhdojmë, ndërkaq presidentja ka drejtat e veta.

Shaip Muja pikërisht këtu qëndron çështja, ata duhet të na dërgojnë, tha.

Murat Hoxha : nuk e kam qartë, me dërgua çështjen apo të na sjellë dokumentacionin.

Shaip Muja : komisioni shqyrton çështjen dhe përcjellë rekomandimin seancës për të vendosur, sikurse që është procedura e rregullt parlamentare, ndryshe kot e kanë.

Adem Salihaj : ky komision është kompetent gjë që ka vërtetua edhe kryesia por duhet të presim materialin nga Qeveria dhe të vazhdojmë punën. **Kryetarja** përkrahu këtë qëndrim të z. Adem pasi Qeveria duhet të dërgoi materialin për shkak të transparencës që duhet ta ketë.

Shaip Muja : sa duhet me prit ky komision. Komisioni duhet të insistoi, të urdhëroi, të kërkoj përmes Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesja pyeti anëtarët prezent për qëndrimet e tyre , komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të drejtohet shkresa Kryesisë së Kuvendit me kërkesën e Komisionit që ajo të kërkoj nga Qeveria procedimin në Parlament çështjen e Demarkacionit bashkë me materialin e Komisionit Qeveritar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.3.2016

Procesverbali 3.3.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi materialit për konkurs

Kryesuesja **Duda Balje** lidhur me konkursin potencoi se duhet të presim takimin e së hënës kur është ftuar Ministri i MMPH pas së cilës duhet të vendoset për ditën e intervistimit të kandidatëve, ngase atë ditë duhet të prezantojnë anëtarët e komisionit dhe mos të mungojnë. Në këtë pikë ajo u fokusua për pyetjet që duhet të bëhen ministrit të

MMPH, ndaj përveç deputetit Murat Hoxha i cili kërkoi që pyetjet e tij të dërgohen sot ma vonë, komisioni u dakordua për pyetjet si vijon :

- raportimi financiar, certifikimi i auditit të brendshëm
- strategjia legislative dhe zbatimi i sajë,
- projektligji i Obiliqit dhe qëndrimi i MMPH rreth projektligjit,
- kriteret e MMPH për ndarjen e investimeve kapitale,
- çështja e vërshimeve dhe masat e ndërmarra,
- çështja e ujit të pijshëm
- diskutimi për rastin pse komisioni ka vendosur negativisht për raportin e gjendjes së mjedist për 2015 nga MMPH, kurse seanca vendosi të kundërtën,
- pyetjet e deputetit Murat Hoxha dërgohen sot gjatë ditës.

4...Të ndryshme

Kryesuesja për këtë pikë sugjeroi si vijon :

- Pasi që GP për projektligjin për mbrojtjen nga Zhurma ka mbajtur takimin sot komisioni duhet te vendos të hënën për leximin në parim në pikën të ndryshme.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Duda Balje